



Prishtinë: 19.12.2008.

Kodi i ZRRE-së: V_145_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_150_12_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_150_12_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Faik Kastrati N.T.SH.P "FK-ANA (shifra e konsumatorit DFE – 9018104), si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së të ZRRE-së të datës 30.07.2007 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 27.07.2007, lidhur me ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 13.06.2007 ekipi i autorizuar i KEK-ut gjatë kontrollimit tek konsumatori kanë përpiluar Procesverbalin nr. 031729 në të cilin theksohet se dyshohet në bllomba shtetërore dhe të dërgohet në kalibrim.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 031729.
- Me datë 05.07.2007 Departamenti për shërbime të konsumatorëve – sektori i kalibrimit, leximit dhe matjes në KEK ka përpiluar Procesverbalin nr. 19/5 në të cilin ka shkruar se njehsori elektrik bllombat shtetërore i ka të falsifikuara dhe se numëruesi është i manipuluar.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 19/5 i datës 05.07.2007.
- Me datë 10.07.2007 ekipi i autorizuar i KEK-ut kanë dalur në vendin e ngjarjes tek konsumatori dhe kanë përpiluar procesverbalin nr. 000479 me çka kanë konstatuar se në bazë të procesit të KEK-ut nr. 031730 konsumatorit i është hequr njehsori i vjetër nr. 39914215 dhe iu është vendosur edhe njehsori i ri me nr. 31975388 si dhe kanë regjistruar pajisjet në lokal për shifrën DFE - 9018104.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 000479.
- Me datë 24.07.2008 KEK-u – Njësia e Ferizajt ka ngarkuar konsumatorin (shifra DFE – 9018104) me shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DFE07HP03253 në shumë prej 7,806.66 €. **Provë:** Fatura e KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar DFE07HP03253.



- Me datë 26.07.2007 konsumatori ka parashtruar ankesë në departamentin për konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.
- Me datë 27.07.2007, departamenti për konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalet e KEK-ut të shërbimit të kontrollës të datës 13.06.2007, protokollet mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik, procesverbalet e KE-ut të qendrës së kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 27.07.2007.
- Me datë 30.07.2007 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut dhe konsumatorit, ka vërejtur se:

- ✓ Proceset e kontrollës dhe të qendrës së kalibrimit paraqesin dyshime për abuzim të pikës matëse nga ana e konsumatorit.
Provë: Procesverbalet e kontrollës dhe të kalibrimit në KEK.
- ✓ KEK-u nuk ka bërë ndonjë analizë të konsumit të konsumatorit për periudhën për të cilën ngarkohet konsumatori për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë.
- ✓ Në bazë të analizave të bëra të konsumit mesatar të konsumatorit para dhe pas heqjes së njehsorit për të cilën dyshohet për abuzim, mund të vërehet se pas heqjes së njehsorit për të cilën dyshohet në abuzim konsumi i energjisë elektrike të konsumatorit është rritur për 2,5 herë:
 1. Konsumi mesatar i energjisë elektrike me njehsor të ri për 12 muaj pas vendosjes së njehsorit të ri është **3111 kWh/muaj**, (periudha 7.'07 – 6.'08), kurse
 2. Konsumi mesatar i konsumatorit për 12 muaj para vendosjes së njehsorit të ri është **1234 kWh/muaj** (periudha 07.'06 – 06.'07).
 3. Njehsori i konsumatorit është pranuar me datë 23.05.2006, dhe faturimi ka filluar nga muaji i 6-të 2006.
Provë : Formulari i inspektimit të KEK-ut i datës 23.05.2006.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmimeve të paraqitura rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **refuzojë** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **refuzojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së, Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Ta shkarkojë konsumatorin nga fatura për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë nr. DFE07HP03253 të datës 24.07.2007, ngase konsumatori është ngarkuar për 24 muaj kurse njehsori është i regjistruar vetëm 13 muaj më parë.
2. Ta ngarkojë konsumatorin për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë në bazë të procedurës dhe kornizës ligjore në fuqi për llogaritjen e energjisë së konsumuar në mënyrë të paautorizuar, në datën e përpilimit të procesit të heqjes së njehsorit të abuzuar.



3. Llogaritja e energjisë së konsumuar në mënyrë të paautorizuar të bëhet sipas procedurës në fuqi në atë kohë “Gazeta Zyrtare e KSAK” Neni 45 dispozita 2 b); sipas kësaj dispozite për llogaritje të energjisë të merret parasysh ngarkesa maksimale e konsumatorit që është 23,45 kW (në bazë të shënimeve të KEK-ut), sezonet e shfrytëzimit (verë dhe dimër) dhe duke e zbritur energjinë e faturuar për këta 13 muaj.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar